

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 220

KONTROLLI I CILËSISË PËR NJË AUDITIM TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date)

PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
Hyrje	
Objekti i këtij SNA-je	1
Sistemi i Kontrollit të Cilësisë dhe Roli i Grupeve të Angazhimit	2-4
Hyrja në fuqi	5
	6
Objekti	
Përkufizimet	7
Kërkesat	
Përgjegjësitë e Lidershipit për Cilësinë e Auditimit	8
Kërkesat Përkatese Etike	9-11
Pranimi dhe Vazhdimi i Marrëdhënieve me Klientin dhe i Angazhimeve të Auditimit	12-13
Caktimi i Grupeve të Angazhimit	14
Kryerja e Angazhimit	15-22
Monitorimi	23
Dokumentimi	24-25
Zbatimi dhe Materiale Të tjera Shpjeguese	
Sistemi i Kontrollit të Cilësisë dhe Roli i Grupeve të Angazhimit	A1-A2
Përgjegjësitë e Lidershipit për Cilësinë e Auditimit	A3
Kërkesat Përkatese Etike	A4-A7
Pranimi dhe Vazhdimi i Marrëdhënieve me Klientët dhe Angazhimet e Auditimit	A8-A10
Caktimi i Grupeve të Angazhimit	A11-A13
Kryerja e Angazhimit	A14-A33
Monitorimi	A34-A36
Dokumentimi	A37

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 220, "Kontrolli i Cilësisë për një Auditim të Pasqyrave Financiare" duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 "Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Nërkombëtare të Auditimit".

Hyrje

Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) trajton përgjegjësitë specifike të audituesit në lidhje me procedurat e kontrollit të cilësisë për auditimin e pasqyrave financiare. Ai adreson, kur është e nevojshme, përgjegjësitë e rishikuesit të kontrollit të cilësisë së angazhimit. Ky standard duhet të interpretohet në kontekstin e kërkesave etike përkatëse.

Sistemi i Kontrollit të Cilësisë dhe Roli i Grupeve të Angazhimit

2. Sistemet, politikat dhe procedurat e kontrollit të cilësisë janë përgjegjësi e firmës së auditimit. Sipas SNKC 1, firma ka detyrim të krijojë dhe mbajë një sistem të kontrollit të cilësisë me qëllimin për ti dhënë asaj sigurinë e arsyeshme se:
 - (a) Firma dhe punonjësit e saj respektojnë standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të aplikueshme; dhe
 - (b) Raportet e lëshuara nga firma apo ortakët e angazhimit janë të përshtatshme për rrethanat.¹
3. Në kontekstin e sistemit të kontrollit të cilësisë së firmës, grupet e angazhimit kanë përgjegjësi për të zbatuar procedura të kontrollit të cilësisë që janë të aplikueshme për angazhimin e auditimit dhe për t'i dhënë firmës informacionin e duhur për të mundësuar funksionimin e asaj pjese të sistemit të kontrollit të cilësisë së firmës që lidhet me pavarësinë.
4. Grupet e angazhimit kanë të drejtë të mbështeten në sistemin e kontrollit të cilësisë së firmës përveç rasteve kur informacioni i mundësuar nga firma apo palë të tjera sugjeron ndryshe. (Ref: Para. A2)

Hyrja në Fuqi

5. Ky standard ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date.

Objektivi

6. Objektivi i audituesit është zbatimi i procedurave të kontrollit të cilësisë në nivelin e angazhimit që i japin audituesit siguri të arsyeshme që:
 - (a) Auditimi të jetë në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore përkatëse; dhe

¹ SNKC 1, *Kontrolli i Cilësisë për Firmat që Kryejnë Auditime dhe Rishikime të Pasqyrave Financiare dhe Angazhime të Tjera të Sigurisë dhe Shërbimeve të Lidhura*, paragrafi 11.

(b) Raporti i auditimit i lëshuar është i përshtatshëm sipas rrethanave.

Përkufizimet

7. Për qëllimet e këtij standardi, shprehjet në vijim kanë kuptimin e dhënë më poshtë:

- (a) Ortaku i angazhimit² - Ortaku ose personi tjetër në firmë, i cili ka përgjegjësinë për angazhimin e auditimit, performancën e tij, dhe për raportin e audituesit që lëshohet në emër të firmës, dhe atje ku kjo kërkohet, ka edhe autoritetin e nevojshëm nga një organ profesional, ligjor ose rregullator.
- (b) Rishikimi kontrollit të cilësisë së angazhimit - Një proces që synon të japë një vlerësim objektiv, përpara ose në datën e lëshimit të raportit të audituesit, për gjykimet e rëndësishme të bëra nga grupi i angazhimit dhe për konkluzionet e arritura në formulimin e raportit të audituesit. Procesi i rishikimit të kontrollit të cilësisë kryhet për auditimet e pasqyrave financiare të entiteteve të listuara dhe angazhimet e tjera të auditimit, nëse ka të tilla, për të cilat firma ka përcaktuar si të nevojshëm kryerjen e rishikimit të kontrollit të cilësisë.
- (c) Rishikues i kontrollit të cilësisë - Një ortak, një person tjetër në firmë, një person i jashtëm me kualifikimin e duhur, ose një grup i përbërë nga këta individë, të cilët nuk janë pjesë e grupit të angazhimit, kanë eksperiencën e nevojshme dhe autoritetin e duhur për të vlerësuar me objektivitet gjykimet e rëndësishme të kryera nga grupi i angazhimit dhe konkluzionet e arritura në formulimin e raportit të audituesit.
- (d) Grupi i angazhimit – Të gjithë ortakët dhe personeli që kryejnë angazhimin, përfshirë çdo individ që firma ose një firmë e rrjetit kontraktin për kryerjen e procedurave të angazhimit të auditimit. Kjo përfshijon ekspertin e audituesit të jashtëm të kontraktuar nga firma ose një firmë e rrjetit³. Termi “grupi i angazhimit” gjithashtu përfshijon individët brenda auditimit të brendshëm të klientit, të cilët japin ndihmë të drejtpërdrejtë në angazhimin e auditimit për rastet kur audituesi i jashtëm është në pajtueshmëri me kërkesat e SNA 610 (i rishikuar në 2013).⁴
- (e) Firmë – Një praktikues i vetëm (person fizik), ortakëri ose korporatë, apo edhe një entitet tjetër profesionistësh kontabël.
- (f) Inspektim - Në lidhje me angazhimet e kryera të auditimit, procedurat që synojnë të japin evidencë lidhur me respektimin, nga grupet e angazhimit, të politikave dhe procedurave të kontrollit të cilësisë të firmës.

² “Ortaku i angazhimit”, “ortaku”, dhe “firma” duhet të interpretohen duke ju referuar ekuivalentëve të tyre në sektorin publik kur kjo është e përshtatshme.

³ SNA 620, “Përdorimi i Punës së një Eksperti të Audituesit”, paragrafi 6(a), jep përkufizimin e ekspertit të audituesit.

⁴ SNA 610 (i rishikuar në 2013), Përdorimi i Punës së Auditimit të Brendshëm, vendos kufizime mbi përdorimin e ndihmës së drejtpërdrejtë. Gjithashtu, ky SNA pranon se audituesi i jashtëm mund të ndalohej nga ligji ose rregullat për të marrë ndihmë të drejtpërdrejtë nga audituesit e brendshëm. Si rrjedhojë, përdorimi i ndihmës së drejtpërdrejtë i përmbahet vetëm situatave të lejueshme.

- (g) Entitet i listuar – Një entitet, aksionet, pjesët e kapitalit apo detyrimet e të cilit, janë kuotuar apo listuar në një bursë të njohur, ose tregtohen sipas rregullave të një burse apo të një organizmi tjetër ekuivalent.
- (h) Monitorimi (vëzhgimi) – një proces i cili përfshin një konsiderim dhe vlerësim të vazhdueshëm të sistemit të kontrollit të cilësisë që përdor firma, ku përfshihet inspektimi periodik i disa angazhimeve të përfunduara të përzgjedhura, i cili ka për qëllim t'i mundësojë firmës të arrijë sigurinë e arsyeshme se sistemi i saj i kontrollit të cilësisë funksionon në mënyrë efikase.
- (i) Firmë rrjeti – Një firmë ose entitet që i përket një rrjeti
- (j) Rrjet – Një strukturë më e gjërë:
- (i) Që ka si synim bashkëpunimin, dhe
- (ii) Që ka qartësisht synim ndarjen e fitimit apo shpenzimeve apo që ndan pronësinë e përbashkët, kontrollin ose menaxhimin, procedura dhe politika të përbashkëta të kontrollit të cilësisë, strategji të përbashkët biznesi, përdorimin e një emri tregtar të përbashkët, ose një pjesë të rëndësishme të burimeve profesionale.
- (k) Ortak – Çdo individ që ka autoritetin të angazhojë firmën në lidhje me kryerjen e një angazhimi të shërbimeve profesionale.
- (l) Personel – Ortakët dhe stafi ekzekutiv.
- (m) Standarde Profesionale – Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) dhe kërkesat etike përkatëse.
- (n) Kërkesa etike përkatëse – Kërkesat etike ndaj të cilave janë subjekt grupi i angazhimit dhe rishikuesi i kontrollit të cilësisë së angazhimit, të cilat përfshijnë zakonisht pjesët A dhe B të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës për Kontabilistët (kodi BNSEK) në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, së bashku me kërkesat, më shtrënguese, kombëtare.
- (o) Punonjës – Profesionistë, të ndryshëm nga ortakët, duke përfshirë çdo ekspert që punësohet nga firma.
- (p) Person i jashtëm i kualifikuar mjaftueshëm – Një individ jashtë firmës që ka aftësinë dhe kompetencën të vepronte si një ortak angazhimi, për shembull një ortak i një firme tjetër, ose një i punësuar (me eksperiencën e duhur) i një organizmi tjetër profesional kontabël, anëtarët e të cilit mund të kryejnë auditime të informacioneve financiare historike, apo të një organizate që ofron shërbimet përkatëse të kontrollit të cilësisë.

Kërkesat

Përgjegjësitë e Lidershipit për Cilësinë e Auditimit

8. Ortaku i angazhimit duhet të marrë përgjegjësi të plotë për cilësinë e përgjithshme të çdo angazhimi auditimi në të cilën ai është caktuar. (Ref: Para. A13)

Kërkesat Përkatëse Etike

9. Gjatë gjithë angazhimit të auditimit, ortaku i angazhimit duhet të jetë vigilent, nëpërmjet vëzhgimit dhe kërkimit të informacioneve, kur është e nevojshme, për evidencën që tregon për mos-respektimin e kërkesave përkatëse etike nga pjesëtarët e grupit të angazhimit. (Ref: Para. A4-A5)

10. Nëse nëpërmjet sistemit të kontrollit të cilësisë apo ndonjë forme tjetër, ortaku i angazhimit vihet në dijeni për çështje që tregojnë se pjesëtarë të grupit të angazhimit nuk kanë respektuar kërkesat përkatëse etike, ortaku i angazhimit, duke u konsultuar me të tjerë brenda firmës, duhet të përcaktojë hapat e nevojshëm. (Ref: Para. A5)

Pavarësia

11. Ortaku i angazhimit duhet të formojë një konkluzion në lidhje me pajtueshmërinë me kërkesat e pavarësisë që zbatohen për angazhimin e auditimit. Për të bërë këtë, ortaku i angazhimit duhet të (Ref: Para. A5):

- (a) Të sigurojë informacionin e duhur nga firma dhe, sipas rastit, nga firma rrjet, për të identifikuar dhe vlerësuar rrethanat dhe marrëdhëniet që krijojnë kërcënim të pavarësisë;
- (b) Të vlerësojë informacionin në lidhje me shkeljet e identifikuara, nëse ka, në lidhje me politikat dhe procedurat e pavarësisë për të përcaktuar nëse ato krijojnë një kërcënim për angazhimin e auditimit; dhe
- (c) Të ndërmarrë veprimet e duhura për të eliminuar kërcënimet ose për t'i reduktuar ato në një nivel të pranueshëm duke zbatuar masa mbrojtjeje ose, kur konsiderohet si e nevojshme, të tërhiqet nga angazhimi i auditimit, kur tërheqja është e mundur sipas legjislacionit apo rregullit përkatës. (Ref: Para. A6-A7)

Pranimi dhe Vazhdimi i Marrëdhënieve me Klientin dhe i Angazhimeve të Auditimit

12. Ortaku i angazhimit duhet të krijojë bindjen se për pranimin dhe vazhdimin e marrëdhënieve me klientin dhe për angazhimet e auditimit janë ndjekur procedurat e duhura dhe duhet të përcaktojë që konkluzionet e arritura në lidhje me to janë të përshtatshme. (Ref: Para. A8-A10)

13. Nëse ortaku i angazhimit siguron informacion që do të kishte rezultuar në refuzim të angazhimit nga firma, në rast se ky informacion do të ishte siguruar më parë, ortaku i

angazhimit duhet t'ia komunikojë këtë informacion sa më parë firmës në mënyrë që ortaku i angazhimit dhe firma të ndërmarrin veprimet e duhura. (Ref: Para. A10)

Caktimi i Grupeve të Angazhimit

14. Ortaku i angazhimit duhet të krijojë bindjen se grupi i angazhimit, dhe çdo ekspert i audituesit që nuk është pjesë e grupit të angazhimit, kanë së bashku kompetencën dhe aftësitë e duhura që:

- (a) Të kryejnë angazhimin e auditimit në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregulloret përkatëse; dhe
- (b) Të bëjnë të mundur lëshimin e një raporti të audituesit që është i përshtatshëm për rrethanat. (Ref: Para. A11-A13)

Kryerja e Angazhimit

Drejtimi, Mbikëqyrja dhe Kryerja

15. Ortaku i angazhimit duhet të mbajë përgjegjësi për:

- (a) Drejtimin, mbikëqyrjen dhe kryerjen e angazhimit të auditimit në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregulloret përkatëse; dhe (Ref: Para. A14-A16, A21)
- (b) Përshtatshmërinë e raportit të audituesit në rrethanat përkatëse.

Rishikimet

16. Ortaku i angazhimit duhet të mbajë përgjegjësi për rishikimet që kryhen në përputhje me politikat dhe procedurat e firmës për rishikimet. (Ref: Para. A17-A18, A21)

17. Ortaku i angazhimit duhet të krijojë bindjen se është siguruar evidenca e nevojshme e auditimit për të mbështetur konkluzionet e arritura dhe për lëshimin e raportit të audituesit, nëpërmjet rishikimit të dokumentimit të auditimit dhe diskutimit me grupin e angazhimit, më ose para datës së raportit të audituesit. (Ref: Para. A19-A21)

Konsultimi

18. Ortaku i angazhimit duhet:

- (a) Të mbajë përgjegjësi për grupin e angazhimit duke ndërmarrë konsultime të nevojshme për çështje të vështira apo të kontestuara;
- (b) Të krijojë bindjen që pjesëtarët e grupit të angazhimit kanë ndërmarrë konsultimin e nevojshëm gjatë kohës së angazhimit, si brenda grupit të angazhimit ashtu dhe midis grupit të angazhimit dhe palëve të tjera në nivelin e duhur brenda apo jashtë firmës;

- (c) Të krijojë bindjen që është rënë dakord me palën e konsultuar në lidhje me natyrën dhe qëllimin dhe konkluzionet e arritura nga këto konsultime; dhe
- (d) Të përcaktojë që konkluzionet e arritura nga këto konsultime janë vënë në zbatim. (Ref: Para. A22-A23)

Rishikimi për Kontrollin e Cilësisë së Angazhimit

19. Për auditimin e pasqyrave financiare të entiteteve të listuara dhe për ato angazhime të tjera në të cilat është vendosur që duhet të kryhet rishikim për kontrollin e cilësisë së angazhimit, ortaku i angazhimit duhet:
- (a) Të përcaktojë emërimin e rishikuesit të kontrollit të cilësisë së angazhimit;
 - (b) Të diskutojë çështjet e rëndësishme që lindin gjatë angazhimit të auditimit, duke përfshirë ato të identifikuar gjatë rishikimit të kontrollit të cilësisë së angazhimit, me rishikuesin e kontrollit të cilësisë së angazhimit; dhe
 - (c) Të mos vendosë datën e raportit të audituesit derisa të përfundojë rishikimi i kontrollit të cilësisë së angazhimit. (Ref: Para. A24-A26)
20. Rishikuesi i kontrollit të cilësisë së angazhimit duhet të kryejë një vlerësim objektiv të gjykimeve të rëndësishme të kryera nga grupi i angazhimit, dhe të konkluzioneve të arritura në formulimin e raportit të audituesit. Ky vlerësim duhet të përfshijë:
- (a) Diskutimin e çështjeve të rëndësishme me ortakun e angazhimit;
 - (b) Rishikimin e pasqyrave financiare dhe të raportit të propozuar të audituesit;
 - (c) Rishikimin e dokumentimit të përzgjedhur të auditimit në lidhje me gjykimet e rëndësishme të kryera nga grupi i angazhimit dhe konkluzionet e arritura; dhe
 - (d) Vlerësimin e konkluzioneve të arritura në formulimin e raportit të audituesit dhe konfirmim të përshtatshmërisë së raportit të propozuar të audituesit. (Ref. A27-A29, A31-A33)
21. Për auditimet e pasqyrave financiare të entiteteve të listuara, rishikuesi i kontrollit të cilësisë së angazhimit duhet të konsiderojë sa në vijim gjatë kryerjes së rishikimit të kontrollit të cilësisë së angazhimit:
- (a) Vlerësimin e pavarësisë nga grupi i angazhimit në lidhje me angazhimin e auditimit;
 - (b) Nëse është ndërmarrë konsultimi i duhur për çështjet e lidhura me opinionet e ndryshme apo çështje të tjera të vështira ose të kontestuara, dhe konkluzionet e arritura nga këto konsultime; dhe

- (c) Nëse dokumentimi i auditimit i përzgjedhur për rishikim pasqyron punën e kryer në lidhje me gjykimet e rëndësishme dhe mbështet konkluzionet e arritura. (Ref: Para. A30-A33)

Diferencat në Opinion

22. Nëse lindin diferenca në opinion brenda grupit të angazhimit, mes atyre që janë konsultuar apo, sipas rastit, midis ortakut të angazhimit dhe rishikuesit të kontrollit të cilësisë, grupi i angazhimit duhet të ndjekë politikat dhe procedurat e firmës për të trajtuar dhe zgjidhur këto diferenca në opinion.

Monitorimi

23. Një sistem efektiv i kontrollit të cilësisë përfshin një proces monitorimi që synon të mundësojë firmën të krijojë bindje për siguri të arsyeshme që politikat dhe procedurat që lidhen me sistemin e kontrollit të cilësisë janë të duhura, të përshtatshme dhe operojnë në mënyrë efektive. Ortaku i angazhimit duhet të marrë në konsideratë rezultatet e procesit të monitorimit të firmës, siç është evidentuar në informacionin më të fundit të qarkulluar nga firma dhe, sipas rastit, me firmat e tjera të rrjetit si dhe nëse mangësitë e evidentuara në këtë informacion mund të ndikojnë në angazhimin e auditimit. (Ref: Para 34-36)

Dokumentimi

24. Audituesi në dokumentimin e auditimit duhet të përfshijë⁵:

- (a) Çështjet e identifikuara në lidhje me respektimin e kërkesave etike përkatëse dhe mënyrën se si ishin zgjidhur.
- (b) Konkluzionet mbi respektimin e kërkesave të pavarësisë që janë të zbatueshme ndaj angazhimit të auditimit, dhe çdo diskutim të përshtatshëm me firmën në mbështetje të këtyre konkluzioneve.
- (c) Konkluzionet në lidhje me pranimin dhe vazhdimin e marrëdhënieve me klientin dhe angazhimeve të auditimit.
- (d) Natyrën, aëllimin dhe konkluzionet e rezultuara nga konsultimet e ndërmarra gjatë kohës së angazhimit të auditimit. (Ref: Para. A37)

25. Për angazhimin e rishikuar të auditimit, rishikuesi i kontrollit të cilësisë duhet të dokumentojë që:

- (a) Procedurat e kërkuara nga politikat e firmës për rishikimin e kontrollit të cilësisë së angazhimit janë kryer;

⁵ SNA 230, *Dokumentimi i Auditimit*, paragrafët 8-11, dhe A6.

- (b) Rishikimi i kontrollit të cilësisë së angazhimit është përfunduar më ose para datës së raportit të audituesit;
- (c) Rishikuesi nuk është në dijeni të ndonjë çështjeje të pazgjdhur që do të shkaktonte bindjen e rishikuesit se gjykimet e rëndësishme të kryera nga grupi i angazhimit dhe konkluzionet e arritura janë të papërshtatshme;

* * *

Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese

Sistemi i Kontrollit të Cilësisë dhe Roli i Grupeve të Angazhimit (Ref: Para. 2)

A1. SNKC 1, apo kërkesat kombëtare të cilat janë të paktën po aq kërkuese, shqyrton përgjegjësitë e firmës për të themeluar dhe për të ruajtur sistemin e saj të kontrollit të cilësisë për angazhimet e auditimit. Sistemi i kontrollit të cilësisë përfshin politikat dhe procedurat që adresojnë secilin nga elementët e mëposhtëm:

- Përgjegjësitë e drejtimit për cilësinë e firmës;
- Kërkesat përkatëse etike;
- Pranimi dhe vazhdimi i marrëdhënieve me klientin dhe angazhimet e veçanta;
- Burimet njerëzore;
- Kryerjen e angazhimit; dhe
- Monitorimin.

Kërkesat kombëtare që shqyrtojnë përgjegjësitë e firmës për të themeluar dhe për të ruajtur një sistem të kontrollit të cilësisë janë të paktën po aq kërkuese sa SNKC 1 atëherë kur adresojnë të gjithë elementët e referuar në këtë paragraf dhe i vendosin firmës detyrime të atilla që arrijnë synimet e SNKC 1.

Mbështetja në sistemin e kontrollit të cilësisë së firmës (Ref: Para. 4)

A2. Grupi i angazhimit mund të mbështetet, nëse nuk ka informacion tjetër nga firma apo palë të tjera që sugjerojnë ndryshe, në sistemin e firmës për kontrollin e cilësisë për shembull në lidhje me:

- Kompetencën e personelit nëpërmjet rekrutimit dhe trajnimeve zyrtare.
- Pavarësinë përmes akumulimit dhe komunikimit të informacionit përkatës.
- Ruajtjen e marrëdhënieve me klientin përmes sistemeve të pranimit dhe vazhimit.

- Përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregulloreve përkatëse përmes procesit të monitorimit.

Përgjegjësitë e Lidershipit për Cilësinë e Auditimit (Ref: Para. 8)

A3. Veprimet e ortakut të angazhimit dhe mesazhet e përshtatshme për pjesëtarët e tjerë të grupit të angazhimit, në mbajtjen e përgjegjësiave për cilësinë e përgjithshme në çdo angazhim auditimi, vënë theksin në:

- (a) Rëndësinë e cilësisë së auditimit për:
 - (i) Kryerjen e shërbimeve që respektojnë standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregulloret përkatëse;
 - (ii) Përputhshmërinë me politikat dhe procedurat e firmës për kontrollin e cilësisë sipas rastit;
 - (iii) Lëshimin e raportit të audituesit që është i përshtatshëm sipas rrethanave; dhe
 - (iv) Aftësinë e grupit të angazhimit për të ngritur çështje pa ndrojtje apo masa ndëshkimore; dhe
- (b) Faktin që cilësia është thelbësore në kryerjen e angazhimeve të auditimit.

Kërkesat Përkatëse Etike

Përputhshmëria e kërkesave etike përkatëse (Ref: Para. 9)

A4. Kodi i BSNEPK përcakton parimet themelore të etikës profesionale, të cilat përfshijnë:

- (a) Integritetin;
- (b) Objektivitetin;
- (c) Kompetencën dhe kujdesin e duhur profesional;
- (d) Kofidencialitetin; dhe
- (e) Sjelljen profesionale.

Përkufizimi i fjalëve “firmë”, “rrjet” ose “firma rrjet” (Ref: Para 9-11)

A5. Përkufizimi i fjalëve “firmë”, “rrjet” ose “firma rrjet” mund të ketë ndryshime nga ai i dhënë në SNA kundrejt kërkesave përkatëse të etikës. Për shembull kodi i BNSEK e përkufizon firmën si:

- (a) Një praktikues i vetëm, ortakëri ose korporatë profesionistësh kontabël;
- (b) Një entitet që kontrollon këto palë nëpërmjet pronësisë, menaxhimit ose ndonjë mjeti tjetër; dhe
- (c) Një entitet i kontrolluar nga këto palë nëpërmjet pronësisë, menaxhimit ose ndonjë mjeti tjetër.

Kodi i BSNEPK jep udhëzime edhe për fjalët “rrjet” dhe “firmë rrjet”.

Duke respektuar kërkesat e paragrafëve 9-11, përkufizimet e përdorura në kërkesat përkatëse etike janë të zbatueshme për sa kohë janë të nevojshme për të interpretuar ato kërkesa.

Kërcënimet ndaj Pavarësisë (Ref: Para. 11 (c))

A6. Ortaku i angazhimit mund të identifikojë një kërcënim ndaj pavarësisë në lidhje me angazhimin e auditimit të cilat nuk mund të eliminohen apo të reduktohen nëpërmjet masave mbrojtëse deri në një nivel të pranueshëm. Në këtë rast, ashtu siç kërkohet nga paragrafi 11 (c), ortakëri i angazhimit raporton tek personat përkatës brenda firmës për të vendosur mbi veprimet e duhura që do të ndërmerren, të cilat mund të përfshijnë eliminimin e veprimtarisë apo interesit që krijon kërcënimin, ose tërheqjen nga angazhimi i auditimit, kur kjo tërheqje është e lejuar nga ligjet dhe rregulloret përkatëse.

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Sektorit Publik

A7. Masa detyruese ligjore mund të ofrojnë mbrojtje për pavarësinë e audituesve të sektorit publik. Megjithatë, audituesit e sektorit publik apo firmat e auditimit që kryejnë auditim të sektorit publik për llogari të audituesit ligjor, në varësi të mandatit në juridiksionin e veçantë, mund të kenë nevojë të modifikojnë qasjen e tyre për të promovuar përputhshmërinë me thelbin e paragrafit 11. Kjo mund të përfshijë, kur mandati i audituesit të sektorit publik nuk lejon tërheqjen nga angazhimi i auditimit, paraqitjen nëpërmjet një raporti publik të rrethanave që kanë lindur dhe që do të rezultojnë në tërheqje të audituesit nëse këto rrethana do të kishin ndodhur në sektorin privat.

Pranimi dhe Vazhdimi i Marrëdhënieve me Klientët dhe Angazhimet e Auditimit

(Ref: Para. 12)

A8. SNKC 1 kërkon që firma të mbledhë informacion të konsideruar si të nevojshëm në rrethanat e caktuara para se të pranojë një angazhim me një klient të ri, kur vendosë për vazhdimin e një angazhimi ekzistues dhe kur merr në konsideratë pranimin e një angazhimi të ri me një klient ekzistues.⁶ Informacioni në vijim mbështet ortakun e angazhimit në përcaktimin e përshtatshmërisë së pranimit dhe vazhimit të marrëdhënieve me klientin dhe angazhimit të auditimit:

⁶ SNKC 1, paragrafi 27(a).

- Integriteti i pronarëve kryesorë, drejtimit kryesorë dhe atyre që janë ngarkuar me qeverisjen e entitetit;
- Nëse grupi i angazhimit ka kompetencën e duhur për të kryer angazhimin e auditimit dhe ka aftësitë e nevojshme, duke përfshirë kohën dhe burimet;
- Nëse firma dhe grupi i angazhimit mund të jenë në përputhshmëri me kërkesat përkatëse etike; dhe
- Çështjet e rëndësishme që mund të kenë lindur gjatë angazhimit aktual apo të mëparshëm të auditimit dhe implikimet për vazhdimin e marrëdhënies.

A9. Ligji, rregullat ose kërkesat përkatëse etike⁷ mund të kërkojnë që audituesi, përpara se të pranojë angazhimin, t'i kërkojë audituesit paraardhës dhënien e informacionit të njohur në lidhje me çdo fakt apo rrethanë që, në gjykimin e tij, audituesi duhet të jetë në dijeni përpara se të vendosë nëse do të pranojë angazhimin. Në rrethana të caktuara, audituesit paraardhës mund t'i kërkojë që, pas marrjes së kërkesës nga audituesi pasardhës, t'i sigurojë këtij të fundit informacion në lidhje me papajtueshmëritë me ligjet dhe rregullat. Për shembull, në rastet kur audituesi paraardhës është tërhequr nga angazhimi si rezultat i papajtueshmërive të identifikuar ose të dyshuara me ligjet ose rregullat, Kodi i BSNEPK kërkon që audituesi paraardhës, pas marrjes së kërkesës nga audituesi pasardhës, t'i sigurojë këtij të fundit të gjitha faktet dhe informacionet e tjera për sa i takon papajtueshmërisë që, në opinionin e tij, audituesi pasardhës duhet të jetë në dijeni përpara se të vendosë nëse do të pranojë angazhimin e auditimit.⁸

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Sektorit Publik (Ref: Para. 12-13)

A10. Në sektorin publik audituesit mund të emërohen në përputhje të procedurave ligjore. Rrjedhimisht, disa prej kërkesave dhe konsideratave të dhëna në paragrafët 12, 13 dhe A8 dhe A9 në lidhje me pranimin dhe vazhdimin e marrëdhënieve me klientin dhe angazhimet e auditimit, mund të mos jenë të zbatueshme. Megjithatë, informacioni i mbledhur si rezultat i procesit të përshkruar në to mund të jetë i vlefshëm për audituesit e sektorit publik në kryerjen e vlerësimeve të rrezikut dhe në kryerjen e përgjegjësisive të raportimit.

Caktimi i Grupeve të Angazhimit (Ref: Para. 14)

A11. Një grup angazhimi përfshin një person që përdor ekspertizën në një fushë të caktuar të kontabilitetit ose auditimit, qoftë i përfshirë apo i punësuar nga firma, nëse ka, i cili kryen procedura auditimi në angazhim. Megjithatë, një person me një ekspertizë të tillë nuk është pjesëtarë i grupit të angazhimit nëse përfshirja e atij personi me grupin e angazhimit mbetet në nivel konsultimi. Konsultimet adresohen në paragrafët 18, A21 dhe A23.

⁷ Shiko, për shembull, Seksionin 210.14 të Kodit të BSNEPK.

⁸ Shiko, për shembull, Seksionin 225.31 të Kodit të BSNEPK.

- A12. Kur merren në konsideratë kompetenca dhe aftësia e duhur që pritet nga grupi i angazhimit në tërësi, ortaku i angazhimit mund të marrë në konsideratë çështje të tilla në lidhje me grupin angazhimit si më poshtë:
- a. Kuptimin dhe eksperiencën praktike në angazhime auditimi me natyrë dhe vështirësi të ngjashme nëpërmjet trajnimit dhe pjesëmarrjes së duhur.
 - b. Kuptimin e standardeve profesionale dhe kërkesave ligjore dhe të rregulloreve përkatëse.
 - c. Ekspertizën teknike, përfshirë ekspertizën e duhur në teknologjinë e informacionit dhe në fushat e specializuara të kontabilitetit dhe auditimit.
 - d. Njohuri të industrisë në të cilën kryen aktivitet klienti.
 - e. Aftësia për të zbatuar gjykim profesional.
 - f. Kuptimin e politikave dhe procedurave të firmës për kontrollin e cilësisë.

Konsiderata të veçanta për entitetet e sektorit publik

- A13. Në sektorin publik, kompetenca e duhur shtesë mund të përfshijë aftësi të nevojshme për të ekzekutuar kushtet e mandatit të auditimit në një juridiksion të veçantë. Këto kompetenca mund të përfshijnë kuptimin e marrëveshjeve raportuese të aplikueshme, duke përfshirë edhe raportimin ndaj ligjvënësit apo ndonjë organi tjetër qeverisës apo në interes publik. Qëllimi i gjerë i sektorit publik mund të përfshijë, për shembull, disa aspekte të auditimit të rendimentit apo vlerësim gjithëpërfshirës së përputhshmërisë me legjislacionin, rregulloret apo autoritete të tjera dhe parandalimi dhe identifikimi i mashtrimit dhe korrupsionit.

Kryerja e Angazhimit

Drejtimi, Mbikëqyrja dhe Kryerja (Ref: Para. 15(a))

- A14. Drejtimi i grupit të angazhimit përshin informimin e pjesëtarëve të grupit për çështje të tilla si:
- a. Përgjegjësitë e tyre, nevojshëm për të qenë në përputhje me kërkesat etike përkatëse, dhe për të planifikuar dhe për të kryer një auditim me skepticizëm profesional siç kërkohet nga SNA 200.⁹
 - b. Përgjegjësitë e ortakëve përkatës kur më shumë se një ortak është i përfshirë në kryerjen e një angazhimi auditimi.

⁹ SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*, paragrafi 15.

- c. Objektivat e punës që do të kryhet.
- d. Natyrën e biznesit të entitetit.
- e. Çështjet e lidhura me rrezikun.
- f. Problemet që mund të lindin.
- g. Qasja e detajuar ndaj kryerjes së angazhimit.

Diskutimi midis pjesëtarëve të grupit të angazhimit lejon që pjesëtarët me më pak eksperiencë të shtrojnë pyetje bashkë me pjesëtarët me më shumë eksperiencë në mënyrë që të ekzistojë komunikimi i duhur brenda grupit të angazhimit.

- A15. Puna në grup dhe trajnimi i duhur ndihmon pjesëtarët me më pak eksperiencë të kuptojnë qartë objektivat e punës së caktuar.
- A16. Mbikëqyrja përfshin çështje të tilla si:
- a. Gjurmimin e progresit të angazhimit të auditimit.
 - b. Marrjen në konsideratë të kompetencës dhe aftësive të pjesëtarëve individual të grupit të angazhimit, duke përfshirë kohën e mjaftueshme për të kryer punën e tyre, nëse i kuptojnë udhëzimet dhe nëse puna kryhet në përputhje me qasjen e planifikuar ndaj angazhimit të auditimit.
 - c. Adresimin e çështjeve të rëndësishme që lindin gjatë angazhimit të auditimit duke marrë në konsideratë rëndësinë e tyre dhe modifikimi përkatës i qasjes së planifikuar.
 - d. Identifikimin e çështjeve për t'u konsultuar apo për t'u marrë në konsideratë nga pjesëtarët me eksperiencë të grupit të angazhimit.

Rishikimet

Përgjegjësitë e rishikimit (Ref: Para. 16)

- A17. Sipas SNKC 1, politikat dhe procedurat e firmës për përgjegjësinë e rishikimit përcaktohen në parimin se puna e pjesëtarëve me më pak eksperiencë rishikohet nga ata me më shumë eksperiencë.¹⁰
- A18. Një rishikim konsiston për shembull në marrjen në konsideratë të çështjeve të tilla si:

¹⁰ SNKC 1, paragrafi 33.

- a. Puna është kryer në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregulloret përkatëse;
- b. Çështjet e rëndësishme janë marrë në konsideratë të mëtijshme;
- c. Konsultimet e duhura janë ndërmarrë dhe konkluzionet e arritura janë dokumentuar dhe zbatuar;
- d. Ekzistenca e nevojës së rishikimit të natyrës, kohës dhe shtrirjes së punës së kryer;
- e. Puna e kryer mbështet konkluzionet e arritura dhe është dokumentuar në mënyrën e duhur;
- f. Evidenca e mbledhur është e mjaftueshme dhe e duhura për të mbështetur raportin e audituesit; dhe
- g. Objektivat e procedurave të angazhimit janë përmbushur.

Rishikimi nga ana e ortakut të angazhimit i punës së kryer (Ref: Para. 17)

- A19. Rishikimi në kohë i pikave të mëposhtme nga ortaku i angazhimit në fazat e duhura gjatë angazhimit lejon zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme në kohën e duhur duke krijuar bindjen e ortakut më ose para datës së raportit të audituesit:
- a. Gjikimi i çështjeve të rëndësishme, sidomos për ato çështje të identifikuara gjatë angazhimit që janë të vështira apo kontestuar;
 - b. Rreziqet e rëndësishme; dhe
 - c. Fusha të tjera që konsiderohen si të rëndësishme nga ortaku i angazhimit.

Nuk është e nevojshme që ortaku i angazhimit të rishikojë të gjithë dokumentimin, por ai mund ta bëjë këtë gjë. Megjithatë, SNA 230 kërkon që ortaku të dokumentojë shtrirjen dhe kohën e rishikimeve.¹¹

- A20. Një ortak angazhimi që vendoset në krye të një angazhimi gjatë kohës që ai është duke u kryer mund të kryejë procedurat e rishikimit të përshkruara në paragrafin A19 për të rishikuar punën e kryer deri në atë datë në të cilën ai është caktuar për të marrë përgjegjësitë e ortakut të angazhimit.

¹¹ SNA 230, paragrafi 9(c).

Konsideratat Përkatëse Kur Përdoret një Pjesëtar i Grupit të Angazhimit, Ekspert në Fusha të Veçanta të Kontabiliteti apo Auditimit (Ref: Para. 15-17)

- A21. Kur përdoret një pjesëtar i grupit të angazhimit, ekspert në fusha të veçanta të kontabilitetit apo auditimit, drejtimi, mbikëqyrja dhe rishikimi i punës së atij pjesëtari të grupit të angazhimit mund të përfshijë çështje të tilla si:
- Rënia dakord me pjesëtarin në lidhje me natyrën, qëllimin dhe objektivat e punës së tij dhe rolet përkatëse si dhe natyrën, kohën dhe shtrirjen e komunikimit midis pjesëtarit dhe pjesëtarëve të tjerë të grupit të angazhimit.
 - Vlerësimi i punës së pjesëtarit duke përfshirë rëndësinë dhe arsyeshmërinë e gjetjeve dhe konkluzioneve të pjesëtarit dhe konsistencën e tyre me evidencën tjetër të auditimit.

Konsultimi (Ref: Para. 18)

- A22. Konsultimi efektiv për çështje të rëndësishme teknike, etike apo çështje të tjera brenda firmës ose, kur është e nevojshme, jashtë saj, mund të arrihet kur ata që konsultohen:
- Pajisen me të gjitha faktet e nevojshme për t'u lejuar që të japin këshilla të informuara; dhe
 - Kanë njohurinë, vjetërsinë dhe eksperiencën e duhur.
- A23. Mund të jetë e nevojshme që grupi i angazhimit të konsultohet jashtë firmës, për shembull kur firma nuk zotëron burimet e nevojshme. Ai mund të fitojë avantazh nga shërbimet këshilluese nga firma të tjera, organe profesionale apo rregullatorë, apo organizata tregtare që ofrojnë shërbime përkatëse të kontrollit të cilësisë.

Rishikimi i kontrollit të cilësisë së angazhimit

Përfundimi i Rishikimit të Kontrollit të Cilësisë së Angazhimit para Vendosijes së Datës së Raportit të Audituesit (Ref: Para. 19(c))

- A24. SNA 700 (i rishikuar) kërkon që raporti i audituesit të ketë një datë që të mos jetë më e hershme se data në të cilën audituesi ka mbledhur evidencën e duhur mbi të cilën bazon opinionin e audituesit për pasqyrat financiare.¹² Në rastin e auditimit të pasqyrave financiare të entiteteve të listuar ose kur angazhimi përmbush kriteret për rishikimin e kontrollit të cilësisë së angazhimit, ky rishikim mbështet audituesin për të përcaktuar nëse ka mbledhur mjaftueshëm evidencën e duhur.

¹² SNA 700 (i rishikuar), *Formimi i opinionit dhe raportimi për pasqyrat financiare*, paragrafi 49.

- A25. Kryerja e kontrollit të cilësisë së angazhimit në kohën e duhur në fazat e duhura gjatë angazhimit mundëson zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme në kohën e duhur nga rishikuesi i kontrollit të cilësisë më ose para datës së raportit të audituesit.
- A26. Përfundimi i rishikimit të kontrollit të cilësisë së angazhimit nënkupton përfundimin e kërkesave të paragrafëve 20-21, dhe sipas rastit, përputhshmërinë me paragrafin 22 nga ana e rishikuesit të kontrollit të cilësisë. Dokumentimi i rishikimit të kontrollit të cilësisë mund të përfundojë pas datës së raportit të audituesit si pjesë e mbylljes së dosjes përfundimtare të auditimit. SNA 230 përcakton kërkesat dhe jep udhëzimet në lidhje me këtë gjë.¹³

Natyrë, koha dhe shtrirja e rishikimit të kontrollit të cilësisë së angazhimit (Ref: Para. 20)

- A27. Ortaku i angazhimit identifikon situatat në të cilat është i nevojshëm rishikimi i kontrollit të cilësisë duke mbetur vigjilent për ndryshimet e rrethanave, edhe në rastet kur rishikimi i kontrollit të cilësisë në fillim të angazhimit nuk kërkohet.
- A28. Shtrirja e rishikimit të kontrollit të cilësisë së angazhimit mund të varet, midis të tjerash, nga vështirësia e angazhimit të auditimit, nëse entiteti është i listuar, dhe nëse rreziku që raporti i audituesit mund të mos jetë i përshtatshëm sipas rrethanave. Kryerja e një rishikimi të kontrollit të cilësisë së angazhimit nuk i zvogëlon përgjegjësitë që ka ortaku i angazhimit për angazhimin e auditimit dhe kryerjen e tij.
- A29. Kur zbatohet SNA 701,¹⁴ konkluzionet e arritura nga grupi i angazhimit në formulimin e raportit të audituesit, do të përfshijnë:
- Çështjet kryesore të auditimit që duhet të përfshihen në raportin e audituesit;
 - Çështjet kryesore të auditimit që nuk duhet të komunikohen në raportin e audituesit, në përputhje me paragrafin 14 të SNA 701, nëse ka; dhe
 - Kur është rasti, në varësi të fakteve dhe rrethanave të entitetit dhe auditimit, faktin që nuk ka çështje kryesore të auditimit për t'u komunikuar në raportin e audituesit.

Përveç kësaj, rishikimi i raportit të audituesit që propozohet, në pajtim me paragrafin 20(b), përfshin edhe vlerësimin e formulimit që propozohet të përfshihet në seksionin e çështjeve kryesore të auditimit.

Rishikimi i kontrollit të cilësisë së angazhimit në entitetet e listuar (Ref: Para. 21)

- A30. Çështje të tjera që mund të merren në konsideratë në rishikimin e kontrollit të cilësisë së angazhimit për entitetet e listuar për të vlerësuar gjykimet e rëndësishme të kryera nga grupi i angazhimit përfshijnë:

¹³ SNA 230, paragrafët 14-16.

¹⁴ SNA 701, *Komunikimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit në Raportin e Audituesit të Pavarur*

- a. Rreziqet e rëndësishme të identifikuar gjatë angazhimit në përputhje me SNA 315 (irishikuar)¹⁵, dhe përgjigjet ndaj atyre rreziqeve në përputhje me SNA 330¹⁶, duke përfshirë vlerësimin e grupit të angazhimit dhe përgjigjet ndaj rrezikut të mashtrimit në përputhje me SNA 240¹⁷.
- b. Gjykimet e bëra veçanërisht për materialitetin dhe rreziqet e rëndësishme.
- c. Rëndësinë dhe natyrën e anomalive të korrigjuara apo të pakorrigjuara që janë identifikuar gjatë angazhimit.
- d. Çështjet që do ti komunikohen menaxhimit dhe atyre të ngarkuar me qeverisje si dhe, kur është e nevojshme, palëve të tjera si për shembull rregullatorit.

Këto çështje të tjera, që varen nga rrethanat, mund të jenë të vlefshme edhe për rishikime të kontrollit të cilësisë së angazhimit për auditimet e pasqyrave financiare të entiteteve të tjera.

Konsiderata të veçanta për entitetet shumë të vogla (Ref: Para. 20-21)

A31. Përveç se është i detyrueshëm për entitetet e listuara, një rishikim i kontrollit të cilësisë së angazhimit kërkohet edhe për angazhime të auditimit që plotësojnë kriteret e përcaktuar nga firma të cilat kriteret përcaktojnë angazhimet që duhet t'i nënshtrohen një rishikimi të kontrollit të cilësisë së angazhimit. Në disa raste, kriteret të cilat nënshtrojnë angazhimet ndaj një rishikimi të tillë nuk i plotëson asnjë prej angazhimeve të auditimit të firmës.

Konsiderata të veçanta për entitetet e sektorit publik (Ref: Para. 20-21)

A32. Në sektorin publik, një auditues që emërohet me ligj (për shembull, audituesi i përgjithshëm, apo një person i përshtatshëm i emëruar për llogari të audituesit të përgjithshëm), mund të veprojë në një rol të njëjlevftshëm me atë të ortakut të angazhimit me përgjegjësi të përgjithshme për auditimet e sektorit publik. Në këto rrethana, kur është e nevojshme, përzgjedhja e rishikuesit të kontrollit të cilësisë së angazhimit përshin marrjen në konsideratë të pavarësisë nga entiteti i auditorit dhe aftësinë e rishikuesit të kontrollit të cilësisë për të dhënë një vlerësim objektiv.

A33. Entitetet e listuara referuar në paragrafët 21 dhe A30 nuk janë të zakonshme në sektorin publik. Megjithatë mund të ketë entitete të tjera të sektorit publik që janë të rëndësishme për nga madhësia, nga aspekti i vështirësisë dhe i interesit publik, të cilat kanë si rrjedhim një gamë të gjerë grupesh interesi. Shembuj të këtyre janë korporatat dhe të mirat publike në pronësi të shtetit. Transformime të vazhdueshme

¹⁵ SNA 315 (i rishikuar), *Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalive të rëndësishme përmes kuptimit të entitetit dhe mjedisit të tij*.

¹⁶ SNA 330, *Përgjigjet e audituesit ndaj rreziqeve të vlerësuara*.

¹⁷ SNA 240, *Përgjigjësitë e audituesit ndaj mashtrimit në një auditim të pasqyrave financiare*.

brenda sektorit publik mund të çojnë në lindjen e llojeve të reja të entiteteve të rëndësishme. Nuk ka kritere objektive të përcaktuara mbi të cilat bazohet përcaktimi i të rëndësishmes. Megjithatë, audituesit e sektorit publik vlerësojnë cilat entitete mund të jenë të rëndësishë së mjaftueshme për të kërkuar kryerjen e rishikimit të kontrollit të cilësisë së angazhimit.

Monitorimi (Ref: Para. 23)

- A34. SNKC 1 u kërkon firmave të krijojnë një proces monitorimi që synon ti japë asaj siguri të arsyeshme që politikat dhe procedurat që lidhen me sistemin e kontrollit të cilësisë janë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe operojnë në mënyrë efektive.¹⁸
- A35. Ortaku i angazhimit mund tu referohet masave të marra nga firma për të ratifikuar situatën në lidhje me mangësi që mund të ndikojnë angazhimin e auditimit, masa të cilat ai i konsideron si të mjaftueshme në kontekst të auditimit.
- A36. Një mangësi në sistemin e firmës për kontrollin e cilësisë nuk është patjetër një tregues që një angazhimi i veçantë auditimi nuk është kryer në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregulloret përkatëse, apo që raporti i audituesit është i papërshtatshëm.

Dokumentimi

Dokumentimi i konsultimeve (Ref: Para. 24(d))

- A37. Dokumentimi i plotë dhe i detajuar mjaftueshëm i konsultimeve me profesionistë të tjerë që përfshijnë çështje të vështira apo që janë kontestuar kontribuon në kuptimin e:
- Çështjes për të cilën është kërkuar konsultim; dhe
 - Rezultatet e konsultimit, duke përfshirë çdo vendim të marrë, bazat e këtyre vendimeve dhe se si ato u zbatuan.

¹⁸ SNKC 1, paragrafi 48.